

# RAPORTI TEKNIK

“SHFRYTEZIM ME KARRIERE E GURIT GELQEROR”

OBJEKTI: “HAMALLOI”

**Me vendodhje:** Pergjat rruges nacionale Vlore - Sarande, Njësia Administrative Sarande,  
Bashkia Sarande, Qarku Vlore.

**Subjekti:** “ARTI” sh.p.k

Hartoi raportin e Teknik duke u bazuar ne te dhenat e subjektit:

“ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS” Sh.p.k

Ing. Elidiana Shehu

(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)



Tetor, 2019

## Tabla Permbledhese

1.	Qëllimin e projektit të propozuar.....	2
2.	Planimetria e vendndodhjes së projektit .....	2
3.	Informacion për qëndrat e banuara .....	5
	<b>3.1 Tendencat Demografike .....</b>	<b>7</b>
	<b>3.2 Ekonomia dhe punesimi .....</b>	<b>7</b>
4.	Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektit .....	9
5.	Përshkrimin e proçeseve ndërtimore dhe teknologjike .....	11
6.	Informacionin për infrastrukturën e nevojshme .....	15
7.	Programin për ndertimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit.....	15
8.	Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe menyra e sigurimit të tyre (materiale ndertimi, ujë dhe energji);.....	16
9.	Informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit; .....	16
10.	Informacion për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;.....	16
11.	Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre; .....	17
12.	Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave .....	18
13.	Informacion për lejet, autorizimet dhe liçencat e nevojshme për projektin .....	18
14.	Kopje të lejeve, autorizimeve dhe liçencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar	

## Raport Teknik

### 1. Qëllimin e projektit të propozuar

Projekti i hartuar ka për qëllim studimin e mundësisë së shfrytëzimit të gurit gelqeror në zonën minerare, objekti "Hamalloi" Bashkia Sarandë, Qarku Vlorë, nga subjekti privat "ARTI" shpk.

Zona Minerare, objekti "Hamalloi", ka një sipërfaqe prej:  $S = 0.05 \text{ km}^2$ .

Sipërfaqja e kerkuar për shfrytëzim është shfrytëzuar më parë nga vete subjekti konform lejes minerare dhe mjedisore e zoteronte për ushtrimin e kativitetit minerar.

### 2. Planimetria e vendndodhjes së projektit

**(ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë)**


Karriera egzistuese e gurit gelqeror, që kërkohet për pajisje leje të re mjedisore nga shoqëria: "ARTI", Sh.p.k, në Zonën Nr.662/1, ndodhet përgjatë rrugës automobilistike Vlorë – Sarandë. Ky objekt ndodhet në Verilindje të qytetit të Sarandës në një distancë në vijë ajrore rreth 1 km larg.

Zona bën pjesë në terren kodrinor, i ndërthurur ndërmjet pjesës fushore kodrinore

Zona përshkohet me rrugë të kategorisë së parë që lidhin zonën minerare me qytetin e Sarandës por edhe me qytete të tjera.


Nga ana morfologjike, relievi paraqitet kodrinor dhe pak i aksidentuar. Pothuajse tërësisht sipërfaqja e zonës që do të shfrytëzohet është e pa pyllëzuar me përjashtim të disa mbulesave vegjetative të degraduara me bimësi, kryesisht shkure të ulëta dhe barishte të cilat në muajt e verës thahen.

## Raport Teknik



Harta 1: Pozicioni i zones minerare ne lidhje me zonate banuara.

Duke pasur parasysh që e gjithë sipërfaqja e shpatit të kodres është e zhveshur dhe ruan njëtrajtësi në rënie, nuk ekzistojnë premiset për sheshpushime dhe grumbullime të lendës humusike dhe fertile për krijimin e rripave të tokës që do të favorizonin zhvillimin e bimesisë.



Harta 2: Pozicioni i zones minerare ne Ortofoto.

Objekti përfshihet në planshetin topografik 1:25,000 me nomenklaturë K-34-5-A-c dhe kufizohet nga pikat me koordinata si më poshtë:




# Raport Teknik

Tabela 1: Koordinatat Gauss Kruger te zone minerare

Nr. pikës	Koordinatat ne Gauss Kruger	
	x	y
1	44 15 780	44 17 671
2	44 15 571	44 17 898
3	44 15 705	44 17 997
4	44 15 917	44 17 755
	<b>Sipërfaqja</b>	<b>0.05 km<sup>2</sup></b>

Sipërfaqja e përgjithshme e zonës së liçencuar për shfrytëzim është **0.05 km<sup>2</sup>** ose **5 ha**.

Në figurën 2.1 tregohen kufijtë e zonës minerare të liçencuar në hartat topografike të shkallëve 1:25,000.




Harta 3: Kufijtë e objektit mbi hartën topografike



## Raport Teknik

**Administrativisht zona në të cilën gjendet karriera egzistuese e zones minerare, objekti Hamalloi përfshihet në territorin e Njesise Administrative Sarande, Bashkis Sarande, Qarku Vlore.**



*Harta 4: Pozicioni i zones ne lidhje me ndarjen administrative*

### 3. Informacion për qëndrat e banuara

**(në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti)**

Karriera egzistuese e gurit gelqeror, që kërkohet për pajisje leje të re mjedisore nga shoqëria: "ARTI", Sh.p.k, në Zonën Nr.662/1, ndodhet përgjatë rrugës automobilistike Vlorë – Sarandë. Ky objekt ndodhet në Verilindje të qytetit të Sarandës në një distancë në vijë ajrore rreth 1 km larg.

Objekti përfshihet në planshetin topografik 1:25,000 me nomenklaturë K-34-5-A-c dhe zë një sipërfaqe prej;  $S = 0.05 \text{ km}^2$  ose  $S = 5 \text{ Ha}$ .

**Administrativisht zona në të cilën gjendet karriera egzistuese e zones minerare, objekti Hamalloi, përfshihet në territorin e Bashkisë Mallakaster, Njesia Administrative Fratar, prane fshatit Damës dhe Kremenar.**

**Bashkia Sarande**

## Raport Teknik

Bashkia e re Sarandë kufizohet në veri me bashkitë Himarë dhe Delvinë, në jug me bashkinë Konispol, në lindje me bashkinë Finiq dhe në perëndim me detin Jon. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Sarandës. Bashkia e re ka dy njësi administrative, qytetin e Sarandës dhe komunën e Ksamilit.



*Harta 5: Bashkia Sarande*

Bashkia e re Sarandë përbëhet tërësisht nga vija bregdetare nga Koka e Qefalit në veri deri te Kanali i Vivarit në jug, ku shërbimet e turizmit detar dhe kulturor përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave. Fshati i Çukës, i cili u shkëput nga Saranda në vitin 1996 për të kaluar në varësi të komunës Aliko, u rikthye me reformën aktuale në varësi të Sarandës. Asetet kryesore ekonomike të qytetit janë deti, peshkimi, liqeni i Butrintit dhe pasuritë e stërmëdha arkeologjike, parku arkeologjik i Butrintit dhe objekte të tjera të rëndësishme si Manastiri i 40 Shenjtorëve, Kalaja e Lëkurësit, Manastiri i Shën Gjergjit, rrënojat e kalasë së qytetit etj. Në territorin e kësaj bashkie gjenden 118 objekte të regjistruara si monumente kulture të kategorisë së parë.

Si një resurs turistik i paçmueshëm, Saranda dhe Ksamili janë përfshirë nga një bum i paprecedent ndërtimi në shumicën e rasteve pa leje, të cilat kanë shkatërruar një pjesë të madhe të potencialit turistik të qytetit ndërkohë që kanë zhytur në krizë infrastrukturën komunale.

Bashkia e qytetit është përpjekur të lehtësojë trafikun duke vendosur një linjë të rregullt autobusësh nga qyteti i Sarandës deri në Butrint por furnizimi me ujë është një problem permanent dhe qyteti ka krijuar një sistem privat dhe të kushtueshëm të furnizimit me autobote.



## Raport Teknik

Bashkia e re do të ketë në territor të saj edhe liqenin e Butrintit, i cili është një qendër e rëndësishme e prodhimit të midhjeve dhe për peshkimin në pikën e lidhjes me detin.

Gjatë viteve të fundit në kurorën e kodrave mbi Sarandë janë mbjellë rreth 30 mijë pisha e selvi, pemë që synohet të veshin malin e Sarandës dhe t'i japin qytetit një kurorë të gjelbër.

Qyteti është zgjeruar gjatë viteve të fundit përmes ndërtimit të disa rrugëve ku e fundit është rruga numër pesë, e cila synon të lehtësojë trafikun në qendër të qytetit si dhe të rrisë kapacitetet për parkingje.

### 3.1 Tendencat Demografike

Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia e re e Sarandës ka një popullsi prej 20,227 banorësh ndërsa në regjistrin civil rezultojnë si popullsi banuese 50,680 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 58.96 km<sup>2</sup>. Sipas censurit, densiteti i popullsisë në bashkinë e re është 343 banorë/km<sup>2</sup> ndërsa sipas regjistrit civil, popullsia është 859.56 banorë/km<sup>2</sup>. Bashkia e re është pothuajse tërësisht urbane me përjashtim të fshatrave Shelegar dhe Çukë, ku fshati Çukë është praktikisht sërish zonë urbane pavarësisht denominimit zyrtar.

#### Bashkia Sarandë

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja KM <sup>2</sup>
Vlorë	Qyteti Sarandë	Sarandë	Qyteti Sarandë, Fshatrat; Gjashtë, Metaq, Çukë, Shelegar	20,227	50680	58.96
		Ksamil	Fshatrat; Ksamil			

### 3.2 Ekonomia dhe punesimi

Zhvillimi ekonomik- Bashkia e Sarandes ka rreth 2.200 biznese gjithsej, nga te cilet 73% jane te vendosur ne qytetin e Sarandes. Mesatarisht 30% e te punesuarve ne zonat jashte qytetit te Sarandes veprojne ne sektorin e bujqesise, nderkohe qe pjesa tjeter jane te shpemdare ne menyre te balancuar ne turizem sherbime, tregti dhe ndertim. Punesimi ne qytetin e Sarandes mbizoterohet nga sherbimet 43% i ndjekur nga tregtia 23%. Bashkimi i Bashkive Sarande dhe Ksamil ne nje me reformen territoriale, krijon nje pol te rendesishem eko- nomik dhe sherbimesh ne rajon. Si rrjedhoje, kjo perben nje avantazh te konsiderueshem, si ne rritjen e te ardhurave ashtu dhe ne kthimin e Bashkise Sarande ne nje lider rajonal persa i perket zhvillimit.

Qyteti i Sarandes eshte nje qender shume e rendesishme per gjithe Bashkine e Sarandes. Qyteti i Sarandes ndodhet ne jugperendim te vendit, buze detit Jon dhe eshte port detar. Porti i Sarandes eshte i treti ne vend per nga rendesia pas Durresit dhe Vlores. Ne ditet e sotme Qyteti i Sarandes cilesohet si nje nga qytetet Perla te Shqiperise dhe aktiviteti i tij eshte bazuar kryesisht ne turizem dhe ne



## Raport Teknik

perpunimin portual". Gjithashtu, ekonomia e qytetit të Sarandës është e bazuar në sektorin e ndërtimit dhe sektorin e shërbimeve. Veprimtaritë ndërtimore në Sarandë kanë qenë veçanërisht intensive në dekadën e fundit, kjo është arsyeja pse ndërtimi është sektori më i madh si në punësim dhe prodhim. Është vlerësuar se gjysma e punësimit total ka të bëjë me aktivitetin e ndërtimit. Sektori i shërbimeve (tregti, bankat, rekreacion) llogaritet për një të tretën e të punësuarëve dhe rreth gjysma e prodhimit është pjesërisht e varur nga turizmi dhe ndërtimi. Në fundi, ekonomia e rrethinave dhe të vendbanimeve të vogla në shkallë rajoni është në një masë të madhe ende rurale dhe e bazuar në prodhimin bujqësor dhe mbareshtimin e kafshëve. Saranda përben një qendër të rëndësishme urbane për vendit që shtrihet në afërsi të drejtperdrejtë të kufijve Greko-Shqiptarë dhe karakterizohet kryesisht nga zhvillimi i turizmit.


*Njesia Administrative e Ksamili* është një ndër prioritetet në Strategjinë e Zhvillimit Kombëtar në drejtim të turizmit dhe si i tillë është në qendër të vëmendjes edhe përsa i përket ndërtimit të tij. Kështu, duke qenë se sektori i turizmit përben një nga burimet kryesore të zhvillimit të zonës, banoret e vlerësojnë atë si të rëndësishëm ose shumë të rëndësishëm për sigurimin e të ardhurave familjare dhe për zhvillimin e gjithë zonës në përgjithësi. Por, urbanizimi kaotik i Ksamilit, me ndërtime pa leje, mungesë të theksuar të infrastrukurës dhe të një standarti arkitekturor, ndikon negativisht në zhvillimet e ardhshme të turizmit dhe aktiviteteve të tilla si rekreacioni dhe vetë Ksamilit dhe gjithë parkut të Butrintit. Në turizëm, sektore prioritarë janë edhe ndërtimi, peshkimi dhe frutikultura. Kultivimi i midhjeve, që kryhet nga rreth 55 biznese, ka qenë një mundësi e mirë punësimi krahas peshkimit që kryhet me mjete të lehta dhe me mënyrën tradicionale. Një burim i rëndësishëm të ardhurash për banoret e zonës janë bërë edhe ngritja e shërbimeve për gjatë vijës bregdetare.

*Peshkimi dhe Akuakultura.* Liqeni i Butrintit është një burim shumë i rëndësishëm për peshkimin dhe midhi ulturen. Shumë i njohur për pasuritë e tij peshkore (70 % të përbërë nga qefujt) dhe prodhimin e midhjes, liqeni i Butrintit u zhvillua deri në 1990 si një ndërmarrje e suksesshme shtetërore, e cila mundi t'i mbijetojë periudhës së tranzicionit pa u demtuar dhe vazhdoi të jetë një aktivitet fitimprurës. Liqeni i Butrintit ka një kapacitet prodhimi prej 120 ton peshk/vit dhe 4500 ton midhje/vit. Për momentin ka rreth 70 impiante midhje funksionale, prej të cilëve 50 janë dhënë në përdorim kundrejt kontratave me qira. Kohët e fundit pjesa më e madhe e impianteve të midhjes përgjatë bregut perëndimor të liqenit janë të abandonuar, për shkak të rritjes së nivelit të ngarkesës mikrobike në ujë nga shkarkimet e pa trajtuara të ujerave të zeza nga Ksamili dhe Manastiri. Në kompensim të saj vihet re ndërtimi i impianteve të reja të tipit galixhant përgjatë bregut lindor të liqenit, sepse kjo pjesë e liqenit duket se është me pak e ndikuar nga ndotja mikrobiologjike.



# Raport Teknik

## 4. Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektit

(si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit)




# Raport Teknik





## Raport Teknik



### 5. Përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike

(përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit)

#### Mënyra e shfrytëzimit

Për të përcaktuar mënyrën e shfrytëzimit u morën në konsideratë këta elementë:

- topografia e zonës së projektit,
- sasia e rezervave të shfrytëzueshme,
- karakteristikat gjeomekanike të shkëmbinjve,
- elementët e shtruarjes dhe koeficienti i zbulimit,

Nga analiza e këtyre faktorëve është parashikuar shfrytëzimi me karrierë i rezervave të llogaritura të objektit.

Gjithashtu, shfrytëzimi me karrierë në qiell të hapur favorizohet dhe nga:

- Fortësia e përshtatshme e mbulesave deluvionale dhe flishore, të cilat gërmohen me lehtësi me forcën mekanike të koves së eskavatorit (Varinsky), por kryesisht me përdorimit të Lëndëve Plasëse;



## Raport Teknik

- Rënia e formacioneve, që ndërtojnë pakon produktive në drejtim të tillë që lejojnë zhvillimin normal të shkalleve dhe elemeteve të tyre pa sjellë kushtëzime teknike. (në drejtim të kundërt me terrenit me një kënd;
- Eksperienca e shfrytëzimit në vitet të kaluara para viteve 1990, ka treguar se elementët e shtruarjes së formacioneve gëlqerore dhe karakteristikat gjeomekanike të tyre favorizojnë kendet e mëdha të skarpatave dhe nuk sjellin asnjë rrezik rrëshqitje;
- Trashësia e vogël, nganjëherë e pa përfillshme, e mbulesës tokë vegjetale ose toke produktive që e bëjnë procesin e zbulimit gati të pa rëndësishëm. Depozitimet terrigjene apo argjilore shpesh janë në formë ndërftuesh në raporte të pa konsiderueshme dhe kryesisht në 2 deri 3 metrat e para të prarejes stratigrafike;

### Regjimi i punës

Regjimi i punës do të jetë me një ndëresë në ditë dhe numri i diteve të punës në muaj do të jetë:  $N_d = 20 \div 22$  ditë në muaj. Punonjësit që do të punësohen do të jenë me eksperiencë në kryerjen e proceseve të ndryshme të karakterit mineral.

### Variantet e hapjes së vendburimit dhe argumentimi dhe zgjedhja e mënyrës së hapjes

Faktikisht objekti është i hapur, mbasi në të është ushtruar aktivitet mineral nga vete subjekti ARTI sh.p.k, por kërkon një rregullim teresor të transhese hapese kapitale ekzistues. Punimet e hapjes së këtij objekti jepen në planimetrinë e karrierës.

Në studimin e varianteve të hapjes së vendburimit, janë marrë në konsideratë:

- Kuota e poshtëme e rrugës ekzistuese;
- Kuota e sipërme e zonës së shfrytëzimit;
- Parametrat gjeometrike të zonës së shfrytëzimit si:
  - Gjerësia e karrierës në plan në pjesën e sipërme të saj;
  - Gjerësia në sheshin e poshtëm të karrierës;
  - Gjatësia e karrierës në pjesën e sipërme;
  - Gjatësia e karrierës në pjesën e poshtme;
- Shpërndarjen e rezervave të nxjerrëshme në shkallë në raport me sasinë e përgjithëshme të rezervave, si në tabelën më sipër.
- Pjerrësinë mesatare më të madhe dhe më të vogël të sipërfaqes së objektit dhe asaj jashtë kufijve të saj.
- Lidhja me rrugë nga ana jug perendimore të karrierës.

Mundësinë e lidhjes me rrugë të pjesës së sipërme të karrierës dhe të pjesës së poshtme të karrierës ose duke përdorur zonë të shfrytëzuar në vitet e mëparëshme.

## Raport Teknik

### **Sistemi i shfrytëzimit treguesit tekniko-ekonomikë të tyre**

Në zgjedhjen e sistemit të shfrytëzimit janë marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Mënyra e ngarkimit dhe transportit të sterilit.
- Mënyra e kryerjes së punimeve të zbulimit.
- Mënyra e ngarkimit dhe transportit të gurit gelqeror pllakore në brendësi të karrierës dhe jashtë saj.

Ngarkimi i gurit gelqeror në sheshet e shkallëve të shfrytëzimit parshikohet të kryet me eskavator me kovë të variueshme;  $V_{kov} = (0.5 \div 1.0) m^3$ . Eskavatori që disponon firma është i pajisur me kovë për dhera dhe për shkëmbinjtë.

Në përgjithësi, gjatë shfrytëzimit të karrierës, me përjashtim të rasteve të veçanta, do të ketë transport me kamionë në një distance të shkurter.

Sistemi i shfrytëzimit që parashikohet të perdoret është i thjeshtë me transport të sterilit brenda karrierës në distancë 50 deri 550 m.

### **Rradha dhe drejtimi i shfrytëzimit**

Në hapjen, përgatitjen dhe shfrytëzimin të këtij objekti do të ndiqet rradha e shfrytëzimit nga lart poshtë dhe në raste të veçanta kur e lejojnë kushtet tekniko minerare do të merret nga poshtë lart, pa prishur rradhën e përgjithshme të shfrytëzimit dhe elementet teknike dhe gjeometrike të karrierës.

Drejtimi shfrytëzimit të objektit do të jetë përgjithësisht nga kufiri për në qendër, duke u zhvendosur në drejtimin Veri Perëndim – Juge Lindje, deri në kufijtë ekstreme të zonës së shfrytëzimit.

Orientimi i përgjithshëm i shkallëve do të jetë sipas izohipseve të terrenit.

### **Mënyrat e rrëzimit të ngurit gëlqeror në karrierë**

Gëlqerorët e këtij objekti janë në forme masive, me një trashësi të ndryshme. Shtresat janë të shkeputura nga njëra tjetra dhe mund të shkeputen nga punët me lende plasese. Përdorimi i eskavatorit në rrëzimin e gëlqerorit konsiston në përdorimin e forcës mekanike të koves së eskavatorit.

Materialin e gerrmuar, eskavatori pjesërisht, e hedh në shkallën e mëposhtme dhe pjesërisht, në shkallën e sipërme. Përdorimi i kësaj metode shoqërohet me daljen e copave të mëdha, sic janë në masiv dhe lind nevoja e ricoptimit të dytë, që mund të bëhet me çekiç hidraulik, që vendoset në krahun e eskavatorit.

## Raport Teknik

### Rrëzimi i gurit gëlqeror në shkallët e karrierës me lëndë plasëse me bira sonde

Rrezimi me puse minash, aktualisht, njihet si metoda me efektive në karriera, mbasi ruhen me mire elementet gjeometrike të shfrytëzimit, si: lartësia e shkallës, këndi i pjerresisë së shpatit të shkallës, gjëresia e sheshit të punës, etj. gjatë zbatimit të saj.

Për shpimin e puseve sipas parametrevë të përcaktuara, do të përdoren sonda shpimi me motor me diegje të brendshme të cilat shpojnë:

- Puse me diametër  $\Phi_{pus} = 80 \div 120$  mm (Rasti ynë;  $\Phi_{pus} = 100$  mm).
- Gjatësia e pusit:  $L_p = 10 \div 12$  m. (Rasti ynë;  $L_p = 11$  m).
- Me pjerresinë të ndryshme dhe vertikale ( $\alpha = 72-73^\circ$ ).
- Me shpejtësi shpimi  $0,05 \div 0,1$  ml/min në formacione normale.

### Pasaportat e shpim-plasjes

Parametrat e pasaportave të shpim plasjes janë bazuar në eksperiencën shumëvjeçare të punës me lëndë plasëse në karrierat e prodhimit të gurit gëlqeror.

Parashikimi i punëve të shpim plasjes është bërë duke patur parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Domosdoshmëria e përdorimit të Lendes Plasëse për rrezimin e gurit gëlqeror;
- Shpimi i birave në pjesët fillestare të hyrjes në shkallë dhe në hapjen e transeve të cekta do të bëhet me çekic shpues pneumatik dorë;
- Në momentin e kryerjes së shfrytëzimit në shkallët e formuara me lartësi 10 m parashikohet të përdoret rrezimi me dhoma minash ose me puse sonde;

Për përdorimin e lëndëve plasëse, kompania do të pajiset me lejen e posaçme që jepet nga Ministria e Mbrojtjes.

Në rastet e rrezimit me puse sondash parametrat e pasaportës së shpim plasjes do të jenë si më poshtë :

- Lartësia e shkallës  $h = 10$  m
- Gjatësia e birës  $l_p = 11$  m
- Diametri i pusit të sondës  $\Phi_p = 100$  mm
- Këndi i skarpatës  $\phi_{sk} = 65^\circ$
- Distanca nga bira në birë  $a = 3$  m
- Distanca nga buza e skarpatës në birë  $b = 4.0$  m
- Vija e rezistencës më të vogël  $W = 6 \div 6.5$  m
- Ngarkesa e Lendes Plasëse për pus  $Q_{LE} = 68.25$  kg
- Volumi mesatar i hedhur për pus sonde  $V = 220 \div 240$  m<sup>3</sup>
- Konsumi specifik i lëndës plasëse  $q = 0.35$  kg /m<sup>3</sup> masiv
- Birrat do të jenë të pjerrta
- Sasia e lendes plasëse për 1 pus sonde është llogaritur 68 Kg

## **6. Informacionin për infrastrukturën e nevojshme**

**(për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rruget ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;)**

Për hapjen, përgatitjen dhe shfrytëzimin e metejshëm të karrierës sipërfaqësore të gurit gelqeror, zona minerare objekti Hamalloj, është e nevojshme të ndërtohet infrastruktura ndihmëse si më poshtë.

### **Rrugët e aksesit**

Rruga e aksesit për në objektin minerar është ekzistuese pasi subjekti "ARTI" sh.p.k ka vite që e shfrytëson këtë zonë minerare dhe ka ndërtuar gjithë infrastrukturën e nevojshme për shfrytëzimin e sajë.

### **Zyra dhe objekte shërbimi**

Sic e përmendëm më sipër që subjekti ka vite që e shfrytëzon këtë zonë minerare dhe për këtë qëllim ka ngritur gjithë infrastrukturën e nevojshme për mirëfunksionimin e aktivitetit.

Në këtë karrierë ekzistuese subjekti ka instaluar objekte të tilla si zyra për administratën, dhomë zhveshje për punonjësit etj.

### **Furnizimi me energji elektrike dhe telefoni**

Gjatë shfrytëzimit të karrierës ekzistuese të gurit gelqeror nuk parashikohet të përdoren makineri dhe pajisje të ndryshme të cilat punojnë me energji elektrike. Makinerit janë të gjitha me motor me djegie të brendshme kryesisht me naftë.

Gjithsesi subjekti e përdorë energjinë elektrike për proceset të tjera si në ambientet e zyrave. Për furnizimin me energji elektrike subjekti ka lidhur kontratë me OSHEE Sarandë.

Lidhja telefonike e vendburimit me subjektin do të bëhet me telefona mobile.

## **7. Programin për ndertimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit**

**(kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit)**

Bazuar në projektin teknik, karriera ekzistuese parashikohet të shfrytëzohet edhe për një periudhë 3 vjeçare, me të derjten e shtyrjes.

Prodhimi që do të realizohet nga shfrytëzimi i karrierës ekzistuese të gurit gelqeror, zona, objekti Hamalloj, do të ketë si destinacion përdorimin e tij si lëndë e parë në industrinë e ndërtimit.



## **8. Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe menyra e sigurimit të tyre (materiale ndertimi, ujë dhe energji);**

Shfrytëzimi i Gurit Gelqeror në këtë objekt është aktiviteti kryesor i subjektit për sigurimin e lëndës së parë, për prodhimin e inerteve të përpunuara dhe fraksionura, për përdorim në industrinë e ndërtimit.

Si lende të para do të konsiderojmë lenden djegëse që do të nevojitet për të vënë në levizje mjetet e punës, dhe lenda plasuese që do të nevojitet për kryerjen e shperthimeve për shkeputjen dhe rrezimin e trupave të mineralit të gurit gelqeror.

## **9. Informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;**

Zona në të cilën gjendet objekti mineral është zonë rurale me aktivitete shumë të kufizuara ekonomike. Veprimtaritë që zhvillohen më së shumti në zonë janë bujqësia dhe blegtoaria. Vrojtimet në terren nuk kanë evidentuar një veprimtari tjetër mineral në afërsi të zonës ku gjendet objekti.

Objekti "shfrytëzim me karriere i gurit gelqeror" është karriere ekzistuese, shpallur si zonë e hapur dhe subjekti do ta shfrytëzojë këtë karriere me qëllim nxjerrjen e gurit gelqeror dhe si destinacion përdorimin e tij në industrinë e ndërtimit.

Projekti do të sjellë bashkëpunime me subjekte të tjera të cilat do të jenë blerësit e lëndës së parë të gurit gelqeror.

Subjekti ka bashkëpunim edhe me OSHEE për furnizimin me energji elektrike.

## **10. Informacion për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;**

Nuk është marrë alternative në konsideratë pasi subjekti ARTI sh.p.k e ushtron aktivitetin e tij mineral në këtë zonë mineralë prej vitesh.

Subjekti është pajisur me leje mineralë Nr. 662/1 për shfrytëzimin e këtij objekti mineralë.

Subjekti "ARTI" Sh.p.k për shvillimin e aktivitetit "Karriere për shfrytëzimin e gelqeroreve (leja mineralë nr. 662/1)" në zbatim të Ligjit nr.8934, datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe ndryshimet e tij është pajisur me **Leje Mjedisore me nr. 122 Prot, datë 14.04.2009, me vendim nr. 5 të Komisionit të lejeve dhe Leje Shfrytëzimi nga Ministria e Industrisë dhe Energjisë.**

## Raport Teknik

Referuar ndryshimeve te mevonshme te bera ne legjislacinin Shqiptare, konkretisht ne zbatim te ligjit nr.10440 date 07.07.2011"Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe VKM-se nr. 686 date 29.7.2015 subjekti "ARTI" sh.p.k per ushtrimin e aktivitetit "Kariere per shfrytezimin e gelqeroreve (leja minerare nr. 662/1) " ne 2017 I eshte nenshtuar procedures se thelluar te ndikimit ne mjedis ku eshte pajisur me **Deklarate Mjedisore me nr/3390/6 Prot, date 28.08.2017, me nr. Identifikimi 590 dhe Vendim 33.**

Gjate zbardhjes se Deklarates Mjedisore u konstatua nje spostim I koordinatave nga zona minerare Nr. 662/1, objekti Hamalloj, Sarande, Qarku Vlore.

Referuar ketij fakti subjekti ka bere kerkese ne Ministrine e Industrise dhe Energjise per ndryshim te koordinatave dhe eshte pajisur **me Urdher te Ministrit te Industrise dhe Energjise Nr.311, date 22.08.2017 "Per ndryshimin e koordinatave te siperfaqes se zones se lejuar minerare nr. 662/1, date 23.08.2012 "Per shfrytezimin e mineralit te gurit gelqerore ne objektin Hamalloj, Sarande, Qarku Vlore.**

Ne pergjigje te kerkeses se subjektit Ministria e Energjise dhe Industrise ka thyer pergjigje per miratimin e ndryshimit te koordinateve te siperfaqes se zones se lejuar minerare 662/1.

Persa me siper me ndryshimet e kryera per koordinata per periudhen e mbetur te shfrytezimit te Objekti minerar Hamalloj, subjekti ARTI sh.p.k po ndjek procedurat per tu pajisur me dokumentacionin perkates mjedisor.

### **11. Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;**

Shfrytezimi i Gurit Gelqeror në këtë objekt është aktiviteti kryesor i subjektit për sigurimin e lëndës së parë, për prodhimin e inerteve të përpunuara dhe fraksionura, për përdorim në industrinë e ndërtimit.

Shfrytezimi i karrieres egzistuese te gurit gelqeror do te siguroje lende te pare ( guri gelqeror) i cili do te kete si destinacion perderimin e tij ne ndertimin e rruges Fieri By Pass.

Si lende te pare ndihmese do te konsiderojme lenden djegese qe do te nevojitet per te vene ne levizje mjetet e pune, dhe lenda plasese qe do te nevojitet per kryerjen e shperthimeve per shkeputjen dhe rrezimin e trupave te mineralit te gurit gelqerore.

## **12. Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave**

Në objekt nuk parashikohen të ndërtohen objekte industriale dhe të shërbimit ato janë ndertuar tashmë dhe vetëm mund të riparohen pjesërisht. Që në fillim të aktivitetit të tij subjekti nuk parshikon ndërtimin e ndonjë ambienti që do të shërbejë si zyra dhe ambient pushimi pasi ne zonen e projektit kemi infrastructure egzistuese ne shërbim te aktivitetit minerare.

Në këtë karrierë nuk parashikohen të ndërtohen objekte të tjera si ambiente magazine dhe sistemime të ndryshme pasi janë ndertuar tashme ne fillin te shfrytezimit te kesaj zone minerare.

## **13. Informacion për lejet, autorizimet dhe liçencat e nevojshme për projektin (në përputhje me përcaktimet e bera në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ liçencimin e projektit)**

Subjekti disponon dokumentacionin e meposhtem

1. Leje minerare me PN-4034-09-2012
2. Urdher te Ministrit te Industrise dhe Energjise Nr.311, date 22.08.2017 "Per ndryshimin e koordinatave te siperfaqes se zones se lejuar minerare nr. 662/1, date 23.08.2012 "Per shfrytezimin e mineralit te gurit gelqerore ne objektin Hamalloi, Sarande, Qarku Vlore.
3. Shkrese nr. 4826/1 prot, date 24.09.2019, Per njehsim te koordinatave te zones minerare Objekti Hamalloi.
4. Miratim i programit vjetor te punes per periudhen 23.08.2019 deri 23.08.2020, me nr 4672/3 date 24.09.2019

## **14. Kopje të lejeve, autorizimeve dhe liçencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar**

**(në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/liçensimin e projektit.)**

Bashkengjitur gjeni dokumentacionin qe disponon subjekti ARTI SHpk per shfrytezinim ne zones minerare objekti Hamalloi ne Sarande.





# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Ekonomisë,  
Tregtisë dhe Energjetikës

## LEJE



PN-4034-09-2012

NUIS/NIPT: J64103808P

Subjekti: ARTI

Adresa: Vlore, SARANDE, Sarande, SARANDE, Lagjja Nr. 1, Rruga Onhezmi

Kodi: IV.1.B.2

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 03/09/2012

Afati i vlefshmërisë: 03/07/2022

Kategoria

Minerare  
Minerare ose hidrokarbure

Nënkategoria

Leje Shfrytëzimi

Veprimtari specifike

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Leje minerare shfytëzimi për Gur Gëlqeror

Kufizime specifike

Leja ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike


Leja ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Objekti "Hamallo", pranë fshatit Nivicë, Sarandë

Nënshkrimi i sportelit:

Artur Moreu







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 ZËVËNDËSKRYEMINISTRI  
 MINISTRI I EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
 Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore  
 Drejtoria e Standarteve Minerare dhe Industriale

Adresa: Bulevardi "Dëshmoret e Kombit", 1001 Tëqja web: <http://www.mcte.gov.al>

Nr. 4209 / Prot.

Tiranë, më 23/08 / 2012

**AKT – MIRATIMI NR. 662/1**

Për Aplikimin në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) për Leje Minerare Shfrytëzimi me nr. LC – 2735 – 02 - 2012, dorëzuar nga ana e subjektit “ARTI” Sh.p.k, për shtytje të afatit të Lejes Mineare të Shfrytëzimit nr. 662 date 03/07/2002, zotëruar nga ana e subjektit

“ARTI” Sh.p.k (leje e mepareshme) për mineralin gur gelqeror që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore, për vendburimin “Hamalloi”, rrethi Sarandë.



1. Të dhëna për përfituesin e lejes minerare të shfrytëzimit:
  - a. Emri i subjektit: “ARTI” Sh.p.k;
  - b. Emri dhe mbiemri i përfituesit të lejes: **Ahilea Papuçi**;
  - c. Lloji i mineralit për të cilin miratohet leja, gur gëlqeror.
  - d. Adresa e selisë së subjektit: **Lagjia Nr.1, Rruga “Onhezmi”, Sarandë.**
  - e. Emri dhe mbiemri i administratorit: **z.Ahilea Papuçi.**
  - f. Nr. telefonit /faksit: ; 069 20 80 737
  - g. Emërtimi i njësisë vendore ku do të kryhet aktiviteti: **Bashkia Sarandë, Qarku Vlorë.**
  
2. Kjo leje jepet në përputhje me nenin 24, dhe kreun e IV të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe i siguron të drejtën ekskluzive subjektit përfitues të shfrytëzojë llojet e mineralit/mineraleve, të përcaktuara në leje, por brenda zonës së lejuar të shfrytëzimit, për një periudhë vlefshmërie prej 10 vjet me mundësi të zgjatjes vetëm një herë të afatit për 10 (dhjetë) vjet, me kërkesë të zotëruesit të lejes së paku 180 (njëqindetëtdhjetë) ditë kalendarike para mbarimit të afatit fillestar të vlefshmërisë.) nga data efektive e dhënies së lejes për shfrytëzim.
  
3. Kjo leje jepet për veprimtarinë minerare të shfrytëzimit të mineralit, gur gelqerore, që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore.
  
4. Koordinatat në plan të zonës së lejuar minerare për zhvillimin e veprimtarisë së shfrytëzimit janë:



Pika	Y	X
1	4415694	4417400
2	4415500	4417640
3	4415640	4417730
4	4415830	4417470

Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare është **0.05 ( zeropikëzeropesë ) km<sup>2</sup>, tije e tere, jo më e vogël se vlera e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të sipërfaqeve të lejeve minerare sipas programit të veprimit, dhe jo më e madhe se 5 (pese) km<sup>2</sup>**. Zona e lejuar minerare për realizimin e veprimtarisë së shfrytëzimit është përshkruar në hartën që bashkëngjitet këtij akti miratimi, firmoset nga Ministri ka vulën e MEET dhe është pjesë e tij.

5. Përfituesi i lejes minerare të shfrytëzimit është i detyruar të respektojë kërkesat e ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; si dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor apo legjislacioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë që lidhen me operacionet e punës së tij gjatë veprimtarisë minerare të shfrytëzimit të mineraleve për të cilët i është dhënë kjo leje. Në mënyrë të specifikuar kërkohet respektimi i afateve ligjore për rastet kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar ose ta pezullojë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar.

6. Përfituesi i lejes minerare brenda afatit të miratuar të lejes minerare të shfrytëzimit duhet të realizojë programin e investimit vjetor dhe atë të investimit total sipas përcaktimeve të tabelës së mëposhtme:

Periudhat e punës sipas viteve të punës.	Aktivitetet	Shpenzimet për programin e investimit në ( leke)
Periudha , ( ...../...../..... ) (viti i pare) ,	Rruge, sheshe e sistemime.	720 000 leke
<b>Totali i investimeve</b>		<b>720 000 leke</b>

7. Veprimtaria minerare e shfrytëzimit gjate periudhes se shteses se afatit te lejes ne programin e investimit sipas projektit te zhvillimit te veprimtarise minerare te shfrytëzimit do të përmbajë këto operacione pune:

1. Zbulim,
2. Prodhim , perpunim guri gëlqeror.

a) Veprimtaria minerare e shfrytëzimit do te realizohet per shfrytëzimin e mineralit:  
Gur gelqeror;

b) Afati shtese i lejes minerare te shfrytëzimit eshte 10 ( dhjetë ) vjet

Sasite e rezervave te mbetura ne vendburim sipas llojit te mineralit jane;

c) Prodhim minerali ne total 1 000 000 m<sup>3</sup>.

d) Prodhim minerali ne vit 10 000 – 50 000 m<sup>3</sup>/vit


e) Rezerva gjeologjike te nxjerrshme 686 790 m<sup>3</sup>.


f) Rezerva gjeologjike gjithsej 1 000 000 m<sup>3</sup>.



Leja nr. 662/1


SH: 1:25,000




MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES  SHOQERIA "ARTI" SH.P.K OBJEKTI "Hamalloi" Vlore		Koordinatat kufizuese		
Leja nr.	662/1	Pika	X	Y
Date	.....	1	4417400	4415694
Minerali	Gelqeror	2	4417640	4415500
Lloji i lejes	Shfrytezimi	3	4417730	4415640
Siperfaqja km <sup>2</sup>	0.05	4	4417470	4415830

Z. LLESHI


Data 15.05.2012

Firma 

4414000 4415000 4416000 4417000







8. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e programit të investimit gjate periudhes se shteses se afatit te lejes minerare e miratuar me vendimin Nr.59, date 25/04/2012 te AKBN ( Nr.4209 prot METE dt 02.05.2012 dhe nr.3403 prot AKBN dt 27.04.2012) është 72 000 ( shtatëdhjetëedymijë ) leke.
9. Vlera e garancisë financiare për realizimin e programit të investimit per periudhen e vitit te pare, gjate periudhes se shteses se afatit te lejes minerare e miratuar me vendimin Nr.59, date 25/04/2012 eshte 72 000 ( shtatëdhjetëedymijë ) leke.
10. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit( karriera dhe impianti i thyerjes) gjate periudhes se shteses se afatit te lejes minerare e miratuar me vendimin Nr.59 date 25/04/2012 ( Nr.4209 prot METE dt 02.05.2012 dhe nr.3403 prot AKBN dt 27.04.2012) është 1 124 700 ( njëmiljonenjëqindenjëzetekatërmijëeshtatëqind) lekë.
11. Vlera vjetore e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit gjate periudhes se shteses se afatit te lejes minerare e miratuar me vendimin Nr.59, date 25/04/2012 është 112 470 ( njëqindedybëdhjetëmijëekatërqindeshtatëdhjetë) lekë.
12. Veprimtaria minerare e shfrytëzimit në zonën e lejuar minerare të shfrytëzimit duhet të respektojë këto kondita specifike:
  - a) Te njohe e te zbatoje rregulloren e teknikes se sigurimit per minierat dhe karrierat.
  - b) Te vleresojë rehabilitimin progresiv dhe perfundimtar te mjedisit dhe te mos shkaktoje demtime te tij.
  - c) Te kontrolloje vazhdimisht dhe te mirëmbaje ne gjendjen teknike sheshet e sigurise ne shkalle dhe ti kushtohet vëmendje ruajtjes se kenditte projektuar per pjerresince shpateve te shkalleve, si dhe ritjen e vemudjes ne ndarjen e shkalles ne neshkalle per nje efektivitate kontroll me te mire te procesit te nxjerrjes.
  - d) Per kushtet gjeografike specifike ne te cilen ndodhet objekti, subjekti duhet te vleresojë sigurimin e mjeteve mbrojtëse individuale per punonjesit, sigurimin e paketes mjekesore te domosdoshme per ndihmen e pare ne raste nevojje si dhe gjate gjithe kohes duhet te mbaje ne gadishmeri makine transporti ne gjendje pune.
  - e) Te vleresojë proceset e punes per rehabilitimin progresiv te objektit minerar dhe menaxhimin e mbeqjeve minerare sipas planit te miratuar.
13. Data efektive e lejes minerare të shfrytëzimit është data e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, të Qendrës Kombëtare të Licencimit.
14. Përfituesi i kësaj leje duhet të respektojë përbushjen në afat dhe me korrektësi për detyrat e lëna nga strukturat përgjegjëse mbikëqyrëse e monitoruese të përcaktuara sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
15. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje ka vlerë legale nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me fax, pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit ose :

MINISTRIT zotit \_\_\_\_\_

- i. me postë: ADRESA Bulevardi " Dëshmorët e Kombit" 1001, Tiranë, Shqipëri
- ii. me fax.: Nr. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
ZOTËRUESI I LEJES SHFRYTËZIMIT

ZOTËRUESIT TË LEJES SHFRYTËZIMIT zotit, Achile Papaçi.

Shoqërisë: "ARTI" Shp.k ;

h. i. me postë : Lagjia Nr.1, Rruga " Onhezmi", Sarandë.

h. ii. me fax: Tel, + Cel; 069 20 80 737

MINISTRI EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERJETIKES

\* Shënim:

Në rastin kur zotëruesi i lejes ndryshon, ose nuk është aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/ kryesor maxhoritar kalimi i të drejtave të lejes minerare të shfrytëzimit tek zotëruesi i ri i bëhet në përputhje me kërkesat e VKM nr.362, datë 29.04.2011 "Për miratimin e kritereve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare".

Në rastin kur zotëruesi i lejes ndryshon, administratorin e shoqërisë, apo drejtuesin teknik, zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të specifikojë emrat, adresat dhe interesin përkatës të personit apo entit përgjegjës për dërejtimin e operacioneve në zonën e lejuar duke njoftuar 10 (dhjetë) ditë kalendarike më parë me shkrim Ministrin për realizimin e këtij ndryshimi.

Ky ndryshim duhet të dërgohet jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike, në Qendrën Kombëtare të Licencimit dhe Ministri sipas ndryshimeve të reflektuara në ekstraktin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

Përgjegjësia e personave që zotërojnë lejen e shfrytëzimit është e përbashkët dhe veç e veç përballë shtetit në lidhje me këtë leje shfrytëzimi.

Ky akt miratimi shoqërohet me aktin e verifikimit të AKBN për lejen minerare Nr.662 dt 03.07.2002 ( nr.4209 prot Mete dt 25.04.2012) për vlerësimin për kushtet e lejimit të AKBN, oponencën e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit dhe Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN Nr.59, date 25/04/2012 " Per shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për zgjatje afati të lejes minerare të shfrytëzimit Nr.662, date 03/07/2002, të subjektit "ARTI" shpk, në zonën minerare objekti " Hamalloi", Sarandë.

EDMOND HAXHINASTO

Tiranë më. .../.../2012



IKAL SHQIPË  
DREKTORISË TË TREGTISË DHE ENREGJETIKËS



10203  
12202/12

**AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE  
DREJTORIA MINERARE**

Tiranë më 27/04/2012

Nr 360 Prot

Lënda *Dërgohet Vendim i Keshillit Teknik*

**Drejtuar: MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENREGJETIKËS  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLITIKAVE TË  
ZHVILLIMIT TË BURIMEVE NATYRORE  
DREJTORISË STANDAREVE MINERARE DHE INDUSTRIALE  
SEKTORIT TË MENAXHIMIT TË KONTRATAVE MINERARE**


**TIRANË**

Bashkelidhur ju dërgojmë, Vendimin e Keshillit Teknik të AKBN-së, nr Nr.59, datë 25.04.2012, për aplikimin në QKL me nr LC-2735-02-2012, të subjektit "Arti" sh.p.k për "Shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për zgjatje afati të lejes minerare të shfrytëzimit nr 662 datë 03.07.2002, të subjektit "Arti" shpk, në objektin e gëlqerorve Hamalloi, Sarandë".

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

Besjan Pasha

Drejtori Ekzekutiv







REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE  
ENERGJETIKES  
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE  
DREJTORIA MINERARE

Adresa:  
Bulevardi "Bajram Curri" Blloku "Vasil Shanto" 48  
Tiranë Shqipëri Tel + 355(0)4 2257117 Fax + 355(0)4  
2257382

**Këshilli Teknik i AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**

**VENDIM**

**Nr.59- datë 25.04.2012**

**Për**

**Shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për zgjatje afati të lejes minerare të shfrytëzimit nr.662 datë 03.07.2002, të subjektit "Arti" shpk, në zonën minerare ne objektin e gelqerorve Hamalloi, Sarandë .**

Ne zbatim të nenit 16, pikat 1 dhe 2, nenit 23, pika 4, nenit 24, pika 6, nenit 26, pika 6 të ligjit nr 10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", pikës 10, të VKM nr.362, datë 29.04.2011 "Për miratimin e kritereve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare" dhe kërkesave të VKM nr 364, datë 04.05.2011, "Për percaktimin e kritereve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare", Keshilli Teknik i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore(AKBN) në mbledhjen e tij të datës 25.04.2012

**A. Pasi u njoh me :**

1. Kërkesën e subjektit "Arti" sh.p.k për shtyrje afati të lejes minerare të shfrytëzimit **nr. 662, datë 03.07.2002.**
2. Vlerësimin për kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese për aplikimin për shtyrje të afatit të lejes minerare shfrytëzimit **nr. 662, datë 03.07.2002,** të subjektit "Arti" shpk, në zonën minerare objektin e gelqerorve Hamalloi, Sarandë
3. Raportin përfundimtar të veprimtarisë së shfrytëzimit të kryer nga subjekti me punimet e kryera, rezultatet, rezervat e shfrytëzuara, shoqëruar me vizatimet e duhura inxhinierike,
4. Vlerësimin dokumentar dhe në terren të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit të përgatitur nga specialistët e grupit të punës të AKBN për punën e realizuar nga subjekti "Arti" shpk sipas zerave të tyre në zbatim të projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare dhe të



detyrimeve të lejes minerare të shfrytëzimit nr. 662, datë 03.07.2002, për zonën minerare Objektin e "Hamalloi", rrethi Sarandë

5. Vlerësimin e grupit të mbikqyrjes dhe monitorimit të AKBN mbi dorëzimin e informacioneve për punimet e kryera dhe rezultatet e ltuara, në respektimin të kërkesave të urdhrave të nr.310, datë 13.04.2011 "Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore dhe nr.312, datë 13.04.2011 "Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së informacioneve të detyrueshme që përgatiten nga zotëruesit e lejeve minerare",
6. Vlerësimin e grupit të mbikqyrjes dhe monitorimit të AKBN mbi dorëzimin në afat të garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit,
7. Vlerësimin dokumentar dhe në terren të përgatitur nga specialistet e grupit të punës të AKBN për realizimin e programit investimit të parashikuar dhe miratuar në projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit
8. Vlerësimin dokumentar dhe në terren të përgatitur nga specialistet e grupit të punës të AKBN për realizimin e planit të prodhimit të parashikuar dhe miratuar në projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit.
9. Vlerësimin dokumentar dhe në terren të përgatitur nga specialistet e grupit të punës të AKBN për realizimin e planit të rehabilitimit të parashikuar dhe miratuar në projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit
10. Vlerësimin dokumentar dhe në terren të përgatitur nga specialistet e grupit të punës të AKBN për levizjen e rezervave dhe gjendjes përfundimtare të tyre të parashikuar dhe miratuar në projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit.
11. Vlerësimin e argumenteve të paraqitur në kërkesën për shtyrje në afat të lejes së shfrytëzimit.
12. Vlerësimin mbi autenticitetin e informacionit gjeologo-minerar në përmbajtjen e Raportit përfundimtar të veprimtarisë së shfrytëzimit të kryer nga subjekti,
13. Vlerësimin e programit të investimit paraqitur në projektin e veprimtarive minerare të shfrytëzimit për periudhën e shtyrjes së afatit,
14. Vlerësimin e programit të shfrytëzimit paraqitur në projektin e veprimtarive minerare të shfrytëzimit për periudhën e shtyrjes së afatit,
15. Vlerësimin e projektit të rehabilitimit të zonës minerare, rrjedhojë e punimeve të shfrytëzimit për periudhën shtesë të lejes minerare: i) projektin veprimtarive të mbylljes; ii) projektin e menaxhimit të mbetjeve minerare; projektin e rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të zonës minerare.
16. Vlerësimin për vlerën e garancisë financiare për realizimin e programit investimit për periudhën shtesë të lejes minerare
17. Vlerësimin për vlerën e garancisë financiare për realizimin e planit rehabilitimit të zonës minerare për periudhën shtesë të lejes minerare.

#### B. Vlerësoi se:

1. Aplikimi për shtyrje të afatit të lejes minerare shfrytëzimi LC-2735-02- date 22.02.2012, i dorëzuar në QKL nga ana e subjektit "Arti" shpk, për minerare objektin e gelqerorve "Hamalloi", Sarandë, plotëson kushtet sipas dokumenteve vërtetuese të paraqitura nga subjekti në përputhje





kerkesat ligjore të ligjit nr 10304, datë 15.7.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij, **për të vijuar procedurat e shtyrjes në afat të lejes minerare shfrytëzimi.**

2. Raporti përfundimtar i veprimtarisë së shfrytëzimit të kryer nga subjekti me punimet e kryera, rezultatet e fituara shoqëruar me vizatimet e duhura inxhinierike **është** i plote
3. Veprimtaria minerare e shfrytëzimit **është realizuar** në zbatim të projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare dhe të detyrimeve të lejes minerare të shfrytëzimit nr. 662, datë 03.07.2002, për zonën minerare
4. Informacionet për punimet e kryera dhe rezultatet e fituara, **janë dorëzuar** në respektimin të kërkesave të urdhrave të ministrit nr.310, datë 13.04.2011 "Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore dhe nr.312, datë 13.04.2011 "Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së informacioneve të detyrueshme që përgatiten nga zotëruesit e lejeve minerare".
5. Garancitë financiare për realizimin e programit të investimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit **janë dorëzuar** në respektim të kërkesave të legjislacionit minerar dhe Vendimit të Këshillit Teknik të Institutit të AKBN për miratimin e projektit të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit dhe/ose kerkim-zbulim-shfrytëzimit,
6. Programi i investimit **është realizuar** në zbatim të projektit të miratuar të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit
7. Plani i prodhimit **është realizuar** në zbatim të projektit të miratuar të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit,
8. Plani i rehabilitimit **është realizuar** në zbatim të projektit të miratuar të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit
9. Argumentet e paraqitur për shtyrje në afat të lejes së shfrytëzimit **merren në konsideratë** për shtyrje të afatit të lejes minerare
10. Informacioni gjeologo-minerar në përmbajtjen e Raportit përfundimtar të veprimtarisë së shfrytëzimit **është** autentik dhe **është bazuar** në punën e kryer nga subjekti
11. Programi i investimit paraqitur në projektin e veprimtarive minerare të shfrytëzimit për periudhën shtesë të shtyrjes të afatit **është hartuar** në përputhje me kërkesat e ligjit nr 10304, datë 15.7.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nenligjore në zbatim të tij,
12. Programi i shfrytëzimit paraqitur në projektin e veprimtarive minerare të shfrytëzimit për periudhën shtesë të shtyrjes të afatit **është hartuar** në përputhje me kërkesat e ligjit nr 10304, datë 15.7.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nenligjore në zbatim të tij,
13. Raporti mbi lëvizjen e rezervave dhe gjendjes përfundimtare të tyre **është në përputhje** me vlerësimin në terren të rezervave minerare dhe rezervave të parashikuara në projektin e zhvillimit veprimtarive minerare të shfrytëzimit.
14. Projekti i rehabilitimit të zonës minerare të shfrytëzimit në Objektivin e Gelqerorve "Hamalloi" për periudhën shtesë të shtyrjes të afatit (pjesë e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit) **është hartuar** në përputhje me kërkesat e legjislacionit minerar dhe atij mjedisor.
15. Projekti i veprimtarisë minerare të shfrytëzimit **ka** përcaktuar drejtë, vlerën e garancise financiare për realizimin e planit të investimit,





16. Projekti i veprimtarise minerare te shfrytezimit ka percaktuar drejte, vleren e garancise financiare per realizimin e planit te rehabilitimit

Në vlerësim të sa me sipër, Këshilli Teknik i Agjencis Kombetare te Burimeve Natyrore.

**V E N D O S E :**

1. Aplikimi per shtyrje te afatit te lejes minerare shfrytezimi LC-2735-02-2012-03-2012, date 22.02.2002, i dorezuar ne OKI nga ana e subjektit "Arti" sh.p.k, per zonen minerare objektin e gelqerorve "Hamalloi", Sarande ploteson kushtet e lejimit sipas dokumentacionit vertetues te paraqitur nga subjekti per te vijuar procedurat e shtyrjes ne afat te lejes minerare shfrytezimi
2. Të miratojë shtyrjen në afat për lejen minerare shfrytezimi nr. 662, datë 03.07.2002, të subjektit "Arti" sh.p.k , në zonen minerare objektin e gelqerorve Hamalloi, rrethi Sarandë
3. Të miratojë projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytezimit brenda afatit të shtyrjes se lejes minerare prej 10 vjetësh, për sipërfaqen e zonës së lejuar të lejes minerare prej 0.049 km<sup>2</sup> sipas koordinatave të dhëna si më poshtë :

Nr	Y	X
1.	44 15 694	44 17 400
2	44 15 500	44 17 640
3	44 15 640	44 17 730
4	44 15 830	44 17 470

4. Të miratojë këto kondita specifike për zhvillimin e veprimtarisë minerare të shfrytezimit si detyruese për subjektin "Arti"sh.p.k., në rast të përfitimt të zgjatjes së afatit të lejes minerare të shfrytezimit.

Te vlerësojë rehabilitimin progresiv dhe perfundimtar te mjedisit dhe te mos shkaktoje demtime te tij

1. Mbeshtetur ne projektin e veprimtarise te shfrytezimit dhe fazave te zbatimit te tij shpenzimet per realizimin e programit te investimit sipas viteve jane

Periudhat e punës sipas viteve të punës	Aktivitetet	Shpenzimet për programin e investimit
<b>Investime totale</b>		<b>720 000</b>
Rruge, sheshe e sistemime		720 000
Viti i pare		<b>720 000</b>

1. Vlera totale e garancise financiare per realizimin e programit te investimit e miratuar me ketë vendim është **(72 000 leke)**.
2. Vlera e garanciseper vitin e pare financiare per realizimin e programit te investimit e miratuar me ketë vendim është **72 000 leke**.
3. Vlera totale e garancise financiare per realizimin e planit te rehabilitimit e miratuar (karriera dhe impianti thyerjes) me ketë vendim është **(1 124 700leke )**.

4. Vlera vjetore e garancisë financiare per realizimin e planit te rehabilitimit e miratuar me ketë vendim eshte(112 470leke ).

Vendimi i Keshillit Teknik te AKBN nr 58, date 25 04 2012, Vleresimi per kushtet e lejimit, oponentca e projektit te zhvillimit te veprimtarive minerare te shfrytezimit se bashku me aktin e verifikimit per periudhen e zgjatjes se afatit te lejes minerare te shfrytezimit per një periudhe 10 (dhjete) vjeçare, i dergohet Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes me date ..... per procedurat e metejshme te vleresimit te aplikimit per shtyrje te afatit te lejes minerare .

Sekretari i Këshillit Teknik



Adhurim Çausi

Drejtori Ekzekutiv i AKBN



Besjan Pesha



NUMBETARE

### OPONENCE

#### mbi

«Studmi tekniko ekonomik dhe projekti i shfrytezimit te gurit gelqeror Hamalloi, Sarande (Kerkese per shtyrje afati te lejes minerare te shfrytezimit Nr. 662 date 03.07.2002)

Materiali i paraqitur eshte pergatitur nga subjekti «Studioprojekt» me administrator ing miniere, Xhevahir Dymishi dhe prezanton aktivitetin 10 vjeçar te subjektit «Arti» shpk, i cili ka patur lejen minerare te shfrytezimit Nr. 662 date 03.07.2002, ne shfrytezimin e gurit gelqeror ne objektin Hamalloi Sarande dhe parashikimin e shfrytezimit edhe per nje periudhe tjeter prej 10 vitesh sipas VKM Nr. 362 dt 29.04.2011 «Per miratimin e kriterëve dhe rregullavete transferimit , menyres se aplikimit per shtyrje afati

Projekti per shfrytezimin e metejsheem te objektit te gelqeroreve "Hamalloi i permbahet kerkesave te Aneksit 2 te Urdherit te Ministrit nr. 304 "Per miratimin e formes dhe permbajtjes se projektit te zhvillimit te veprimtarise minerare".

Projekti eshte ndertuar ne relacionin prej 44 faqe dhe nga materiali grafik me 9 vizatime si dhe skica te ndryshme

Projekti i paraqitur parashikon vijimin e shfrytezimin brenda siperfaqe se lejes ekzistuese prej 0.049 km<sup>2</sup> dhe ka koordinatat si ne tabelen

Nr.	Y	X
1.	44 15 694	44 17 400
2.	44 15 500	44.17 640
3.	44 15 640	44 17 730
4.	44 15 830	44 17 470



Siperfaqja e zones eshte 0.049km<sup>2</sup>

Projekti eshte i ndertuar ne kapituj te vecante dhe ne sejcilin prej tyre trajtohen elementet perkates, te dhena te pergjitheshme per gjeografine e zones, vendndodhja e objektit, te dhena mbi gjeologjine, mbi llojine e mineralit, punimet e kryera gjendjen aktuale te minieres, duke bere edhe llogaritjen e rezervave te mbetura pa u shfrytezuat ne objektit te cilat jane rreth 1 milion m<sup>3</sup> dhe ne projektin e paraqitur merren ne konsiderate 686790m<sup>3</sup> mbi te cilat eshte ndertuar edhe grafiku i prodhimit per 10 vjeçarin 2012 deri 2022

Pjesa minerare e studimit, e ndertua mbi te dhena e deritanishme te shfrytezimit te karneres trajton menyren e kryerjes se shfrytezimit, koeficientin e zbulimit, kapacitetin e nxjerrjes se prodhimit qe sipas kerkeses se subjektit te interesuar eshte parashikuar te jete 10-50000.m3/vit

Mbi prodhimin vjetor të parashikuar, studimi trajton elementet e prodhimit, regjimin e punes, grafikun e prodhimit dhe te zbulimit ne vite.

Nisur nga pozicion topografik dhe vendosja e objektit, studimi merr ne analize hapjen e metejsheem, duke percaktuar rrugen kryesore (magjistralin) per te shkuar ne kuotat e siperme te

AS

*[Handwritten signature]*



karrieres. Sipas studimit magjstrali kryesor do te sherbeje rruga ekzistues e cila kalone ne pjesen jugore te zones dhe ngjitet deri ne horizontin me te siperm dhe ne çdo lartesi ngjitje 10 m do te hapen degezimet per ne sejcilen shkalle

Per varjantin e zgjedhur, studimi paraqet elementet kryesore teknik te karrieres. Kjo gje eshte paraqitur edhe grafikisht ne harten topografike te shkalles 1:1000 si dhe profilet e karrieres ne fund te shfrytezimit

Studimi vijon me elementet e sistemit te shfrytezimit, menyren e kryerjes se punimeve ne prodhim dhe zbulim, radha dhe drejtimi i shfrytezimit si dhe grafiku i prodhimit

Ne kapitullin mbi lendet plasese, studimi trajton elementet e shpim-plasjes duke dhene edhe pasaportat e perkatese per varjantin me bira sondash duke perjashtuar perdorimin e dhomave te minave si nje eksperience jo efektive e perdorur deri me sot ne disa subjekte

Ne pasaporten e shpim-plasjes jepen parametrat perkates te shpimit si lartesia e shkalles, gjatesia dhe diametri i bires, kendi i pjerresise se shkalles, distanca nga buza e shkalles si dhe ngarkesen e lendes plasese me konsumin specifik prej  $0.28 \text{ kg/m}^3$

Si lende plasese rekomandohet te perdoret ANFO duke dhene edhe te dhena per treguesit teknik te lendes plasese

Ne studim eshte trajtuar rrjeti i shperthimit. Jene llogaritur elementet teknik te frontit te prodhimit dhe llogaritjet e makinerive te shpimit te puseve dhe materialeve te lendes plasese, metodikat e mbushjes se puseve me lende plasese, duke e shoqeruar me pasaporten perkatese. Ne tekst jepen llogaritjet per rrjetin e shperthimit

Nisur nga detyre qe i eshte dhene autoreve te projektit, jepen llogaritjet perkatese per volumet e punes ne ngarkim, transport dhe zbulim duke llogaritur elementet e ciklit perkates si dhe listen e makinerive e pajisjeve te domosdoshme per te realizuar prodhimin prej  $10\,000 \text{ m}^3$  ne vit, te cilat, subjekti i disponon

Studimi trajton zgjedhjen e shesheve te depozitimit te mineralit dhe sterileve te dala gjate procesit te prodhimit ne karriere, regullat e teknikes se sigurimit ne karriere sipas profesioneve dhe gjate puneve me lende plasese, lendeve plasese

Duke qene se ne objekt do te perdoret lende plasese, ne studim llogariten distancat e rrezikshme nga perdorimi i tyre te dala nga llogaritjet me formulat e njohura ne minierat siperfaqesore.

Regjimi i punes ne objekt parashikon te punohet me 22 dite pune dhe ne raste te vecanta mund te punohet me dy tume per gjithë vitin.

Ne pjesen ndertimore projekti parashikon hapjen e rrugeve hyrese ne objekt, mbasi subjekti disponon gjithë infrastrukturen e nevojshme si makineri e pajisje ngarkimi dhe transporti impiantin e thyerejes dhe fraksionimit

Ne keto kushte projekti nuk parashikon nevojte per investime te tjera te metejshme. Ato tashme jane kryer.

Ne pjesen ekonomike te studimit eshte bere e qarte se Subjekti ka te ngritur infrastrukturen e nevojshme per pune normale ne object

Ne object eshte i ngritur impianti i thyerjes dhe fraksionimit me kapacitet  $100\,000 \text{ m}^3/\text{vit}$  i cil punon me kapacitet te reduktuar sipas kerkesave te vete subjektit apo te tregut ne pergjithesi

Pjesa ekonomike trajton edhe elementet e kosos dhe treguesit e pritshem financiar

Ne pjesen grafike te studimit jane praqitur vizatimet, si me poshte:

TEKONOMIJA  
E  
TRREGJ

- Harta ne shkalle 1:25 000 me zonen e karrieres
- Harta gjeologjike topografike me gjendjen e karrieres 1 janar 2012
- Prekje terthore gjeologjike dhe te gjendjes perfundimtare ne shkalle 1:1000
- Planimetria e gjendjes perfundimtare te karrieres ne shkalle 1:1000
- Harta topografike me zonen e influences se minave
- Planimetria e rrugeve te karrieres
- Pasaporta e shpim plasjes

Pjesa e studimit te paraqitur eshte edhe pjesa e ketij projekti eshte "Plani i Rehabilitimit te zones se licensuar gjate dhe ne perfundim te shfrytezimit" i perbere nga relacioni prej rreth 25 faqe dhe materiali grafik ku tregohet realizimi i rehabilitimit ne planimetri dhe profile dhe jepen gjithashtu edhe skema mbjellje dhe elemete perkates te tij

Ne planin e rehabilitimit siperfaqja e karrieres ne fund te shfrytezimit do te jete rreth 2.74 ha dhe kostoja e pergjithshme e rehabilitimit llogaritetesi me poshte

- Siperfaqja qe do te rehabilitohet 2.74 ha
- Shpenzimet per mbyllje menaxhim mbetjesh dhe rehabilitim per 1 ha .63129 leke
- Shpenzime e pergjithshme per rehabilitimin e siperfaqes se shfrytezuar 1729730 leke
- Shpenzime (garancia vjetore) per mbyllje, menaxhim mbetjesh, e rehabilitim 172973 leke /vit.

Autoret e oponentes, mendojne se ,materiali i paraqitur per shtyrjen e afatit te lejes minerare Nr. 662, date 03.07.2012, pasqyra e gjendjes aktuale te karrieres si persektiven e zhvillimit per nje perudhe tjeter eshte e mbeshtetur teknikisht dhe mbeshtetet kerkesa per shtyrjen e afatit te lejes edhe per nje 10 vjeçar mbasi

- Subjekti ka te ngritur infrastrukturen e nevojshme pe vijimin e procesit te shfrytezimit ne objekt
- Rezervat e mbetura garantojne pune normale edhe per nje perudhe tjeter prej 10 me prodhimin e planifikuar prej 10 000 m3deri 50 000 m3ne vit.

Duke vleresuar se studimi i paraqitur, si relacioni ashtu edhe materialin grafik, paraqet gjendjen aktuale dhe garanton ecurine e aktivitetit per nje perudhe tjeter 10 vjeçare, ftojme Keshillin Teknik te AKBN te miratoje «Studim tekniko ekonomik dhe projekti i shfrytezimit te gunt gelqeror Hamalloi, Sarande, paraqitur nga subjekti «Arti» sh.p.k, per aplikim per shtyrjen e afatit e lejes mimerare Nr. 662, date 03.07.2002 sipas ligjit 10304 dt 15.07.2010 dhe VKM nr 362 dt 29.04.2011.

Oponentet

Murat Rreshka

Adhurim Çauhi

Tirane, 21.03.2012



## AKT -VERIFIKIMI

Per "Shtyrje afati te lejes minerare te shfrytezimit",  
per grupin e mineraleve ndertimore.

Data .13. 03. 2012. Ora 10.00.

Për objektin Kariera e Gurit Gelqeror, ne venburimin Hamallo, Nivice, Sarande, Rrethi Sarande, ne qarkun e Vlores.

1 Shoqëria "Arti" sh.p.k. me administrator z Arqile Papuçiu, me adrese Lagja nr.2 Sarande, Rrethi i Sarandes, me nr.tel 355 42 263 01ka realizuar kërkesën, drejtuar institucionit të Qendres Kombetare te Licensimit. (Q.K.L), në datën 20.02.2012, me Nr. LC-2735-02-2012, për "Shtyrje afati te Lejes minerare te shfrytezimit nr.662 dt.03.07.2002", i cili, bazuar në Ligjin Nr. 10.304, datë 15/07/2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" i përket grupit te mineraleve ndertimore. Nisur nga kjo kerkese, A.K.B.N, beri aktverifikimin, për zonën minerare, qe përfshin objektin ne fshatin Nivice, Rrethi i Sarandes, Qarku Vlores për t'u pajisur, me leje minerare shfrytëzimi, për "Gure Gelqeror".

2. Nga vlerësimi i materialeve dokumentare, verifikimi në database dhe verifikimi ne terren i specialisteve te AKBN, i përbërët nga inxhinierë: Markshajder, Miniere dhe Gjeolog, rezulton se

- a) Zona e kërkuar për zhvillimin e aktivitetit te shfrytëzimit kerkon: "Shtyrje te afatit te Lejes minerare te shfrytezimit",
- b) Koordinata e zonës se kërkuar janë si në tabelën mëposhtme

Tabela Nr 1 Koordinatat e pikave kufizuese te zonës se kërkuar

nr	Y	X
1	44 15 694	44 17 400
2	44 15 500	44 17 640
3	44 15 640	44 17 730
4	44 15 830	44 17 470

- c) Ato janë në përputhje me kërkesën e subjektit.
- d) Sipërfaqja e zonës së kërkuar për shfrytëzim është  $0.05\text{km}^2$  qe eshte në përputhje me kërkesën e subjektit
- e) Sipërfaqja e zonës së kërkuar nuk është e mbuluar me një akt tjetër verifikimi për leje minerare.
- f) Sipërfaqja e zonës së kërkuar është licencuar më parë për aktivitetet shfrytezimi nga vete subjekti ne fjale
- g) Sipërfaqja e zonës së kërkuar nuk mbivendoset me zonë të licencuar më parë dhe ku lejet minerare janë aktive.

# 



- n) Zona e kërkuar ka lidhje me infrastrukturën rrugore.
- i) Zona e kërkuar ka lidhje me infrastrukturën elektrike, telefonike dhe elemente të tjere
- j) Në afërsi të zonës së kërkuar, që parashikohet të nënshtrohet shfrytëzimit, nuk ndodhen ndërtesa banimi.
- 4) Operacionet e ndryshme të shfrytëzimit që do të zhvillohen nuk do të kenë efekte në objekte të ndryshme në sipërfaqe.
- l) Nga vlerësimi i zonës rezulton se në këtë zonë nuk ka:
- Pasuri natyrore.
  - Toka bujqësore, pyje, kullota,
  - Ka vepra të infrastrukturës si: rrugë automobilistike, linja tensioni, etj.
  - Nuk ka vendbanime, objekte social kulturore, vepra arti, burime uji etj.
  - **Vepra të tjera të mbrojtura me ligj, nuk ka:**
- m) Brenda zonës së kërkuar nuk ka monumente të karakterit të ndashëm, historike, të trashëgimisë kulturore, gjeomomente të arkeologjisë apo të tjera të cilat mund të demtohen nga ushtrimi i aktivitetit minerar.

3 Akti i verifikimit shogërohet me:

a) Hartën topografike në shkallë 1:25 000 me ngjyra, me konfigurimin e sipërfaqes, tabelën e koordinatave shtetërore në plan të pikave kufizuese si dhe sipërfaqen.


b) Planimetrinë e vendosjes së subjekteve të licencuara në këtë zonë në shkallën 1 : 10 000.

4) Për sa më sipër subjekti të vazhdojë procedurat e mëtejshme për t'u pajisur me leje minerare shfrytëzimi, në përputhje me Ligjin Nr. 10304, datë 15/07/2010, Neni 24, pika 6. "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe pika nr. 10, e V.K.M, nr. 362, dt 29/04/2011.

Verifikimi u krye nga:

Ing. Gjeolog

Fredi MANÇKA



Drejtori Ekzekutiv

Besjan PESHA



Ing. Markshajder

Ilir HASANI




Ing. Miniere

Sokol SMOKTHINA



Sekretari i këshillit teknik

Muhamet CURA







# HARTA TOPOGRAFIKE ME ZONEN E KERKUAR

## Subjekti "Arti" shpk


SH 1:25.0

Nomenklatura K-34-5-A-c



		AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE DREJTORIA MINERARE	
		KOORDINATAT E ZONES	
Nr	Y	X	
1	4415694	4417400	
2	4415500	4417640	
3	4415640	4417730	
4	4415830	4417470	
S = 0.0498 km <sup>2</sup>			





4415000

4416000

4418000

4417000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË MINIERAVE

Nr. 5963 Prot.

Tiranë, më 14/9 /2017

DREJTUAR: Znj. PRANVERA FAGU, DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
Qendra Kombëtare e Biznesit

TIRANË

Z. ELION SEMANAJ, DREJTOR EKZEKUTIV  
Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore  
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Nr. 18

TIRANË

Z. RAMIZ HOXHA, DREJTOR  
Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera  
(AKSEM)  
Rruga "Lord Bajron", Laprakë

TIRANË

Z. AHILEA PAPUÇI, ADMINISTRATOR ✓  
Shoqëria "ARTI" sh.p.k.  
Lagjja nr.1, Rruga "Onhezmi", Sarandë

VLORË ✓

Lënda: DËRGIM URDHËRI

Të nderuar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për zbatim, Urdhrin e Ministrit Nr. 311, datë 22.08.2017, "Për ndryshimin e koordinatave të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare Nr. 662/1, datë 23.08.2012, për shfrytëzimin e mineralit të gurit gëlqeror në objektin "Hamalloi", Sarandë, Qarku Vlorë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË MINIERAVE

URDHËR

Nr. 311 datë 22 . 08 .2017

**PËR NDRYSHIMIN E KOORDINATAVE TË SIPËRFAQES SË ZONËS  
SË LEJUAR MINERARE NR.662/1, DATË 23.08.2012, PËR  
SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË GURIT GËLQEROR NË  
OBJEKTIN HAMALLOI, SARANDË, QARKU VLORË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 120 të ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Urdhrit Nr.177, datë 26.05.2016 "Për rikonfigurim të sipërfaqes së lejeve minerare", si dhe shkresës së Strukturës Përgjegjëse, AKBN, Nr.1787, datë 21.03.2017, me qëllim përputhjen e sipërfaqes së lejes minerare me të dhënat e trupit minerar dhe shmangien e mbivendosjeve,

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e koordinatave të lejes minerare nr.662/1, datë 23.08.2012, me qëllim përputhjen e sipërfaqes së lejes minerare me të dhënat e trupit minerar.
2. Duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, koordinatat dhe sipërfaqja e lejes minerare nr.662/1, datë 23.08.2012 do të ndryshojë si në tabelën dhe hartën bashkëlidhur.

Ishin			Bëhen		
Pika	Kordinatat		Pika	Kordinatat	
	X	Y		X	Y
1	4417400	4415694	1	4417671	4415780
2	4417640	4415500	2	4417898	4415571
3	4417730	4415640	3	4417997	4415705
4	4417470	4415830	4	4417755	4415917
Sipërfaqja = 0.05 km <sup>2</sup>			Sipërfaqja = 0.05 km <sup>2</sup>		


3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen AKBN, AKSEM, QKB dhe Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Minierave.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


**MINISTRI**

**DAMIAN GJIKNURI**








**MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË**  
**DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË MINIERAVE**  
**OBJEKTI "Hamalloi", Qarku Vlorë**

Leja nr.  
 Subjekti  
 Minerali  
 Lloji i lejes  
 Sipërfaqja, km<sup>2</sup>  
 data  
 Neritan Aleks

**Leja Nr.662/2**  
**"Arti" sh.p.k**  
**Gur gëlqeror**  
**Shfrytëzimi**  
**0.05**  
 data  
 firma  
*Aleks*

Kordinatat		
Pika	X	Y
1	4417671	4415780
2	4417898	4415571
3	4417997	4415705
4	4417755	4415917



4414000

4414000

4414000

4415000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE  
DREJTORIA MINERARE

Nr. 4826/1 prot.

Tiranë, më 29.09.2019

Lënda: Kthim përgjigje.

**Z. Arqile Papuçi, Administrator i lejes minerare Nr. 662/2, datë 23.08.2012**

**Rruga "Onhezmi", lagjia Nr. 1, Sarandë, Vlorë**

**Nr. Kontakt: 0692080737**

Në përgjigje tuajës me Nr. 12 Prot, datë 25.07.2019, hyrë në AKBN me Nr. 4826 Prot, datë 29.07.2019 me lëndë "Kërkesë për njehësim koordinatash" ju bëjmë me dije se:

Sipas Urdhërit të Ministrit Nr. 311, datë 22.08.2017 koordinatat e lejes minerare Nr. 662/2, datë 23.08.2012 në Sistemin Gauss-Kryger dhe të konvertuara në sistemin KRGJSH janë:

Koordinatat e lejes Nr.662/2 Sistemi Gauss-Kryger		
Nr.	Y	X
1	4415780	4417671
2	4415571	4417898
3	4415705	4417997
4	4415917	4417755
Siperfaqja = 0.05 km <sup>2</sup>		

Koordinatat e lejes Nr.662/2 Sistemi KRGJSH		
Nr.	Y	X
1	501184.6105	4417075.006
2	500973.1024	4417299.632
3	501105.9735	4417400.116
4	501320.6492	4417160.526
Siperfaqja = 0.05 km <sup>2</sup>		

Bashkangjitur harta topografike në shkallën 1:25 000 me kufijtë lejes minerare Nr. 662/2, datë 23.08.2012 në Sistemin KRGJSH:


Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

DREJTORI EKZEKUTIV

Adrian BYLYKU



**HARTA TOPOGRAFIKE ME KUFIJTE E LEJES MINERARE NR. 662/2, SARANDE  
SISTEMI KRGJSH  
Shk 1: 25 000**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE  
DREJTORIA MINERARE

Nr. 4672 / Prot.

Tiranë, më 24 09 / 2019

Lënda:

MIRATIMI I PROGRAMIT VJETOR TË PUNËS  
PËR PERIUdhËN 23.08.2019 deri 23.08.2020

“ARTI”shpk

Z. Alqi Xoro

Lagjja nr.1,Rruga Onhezmi, Sarandë, Vlorë. ✓

Grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr. 8 datë 16.01.2018, të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-s “Për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit të planit vjetor të punës nga zotëruesit e lejeve minerare”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr.10304, datë 15/07/2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe të VKM nr. 232, datë 23/03/2011 “Për Miratimin e Funksioneve të Strukturave Përgjegjëse në Sektorin Minerar të Republikës së Shqipërisë”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga ana Juaj, vendosi:

Miratimin e Programit Vjetor të Punës, për Lejen Minerare Nr. 662/1 datë 23.08.2012, Objekti: “Hamalloi”, Sarandë për shfrytëzimin e mineralit Gur Gëlqeror, për periudhën 23.08.2019 deri më datë 23.08.2020.

Ju bëjmë me dije, se zbatimi i programit vjetor të punës për periudhën 23.08.2019 deri më datë 23.08.2020, nga ana e shoqërisë Tuaj, do të jetë objekt i kontrollit të vazhdueshëm nga strukturat tona të specializuara.

Në zbatim të nenit 18 pika 1/ç, 25/ç dhe 27 pika 2/c të ligjit nr.10304, datë 15/07/2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i licencuar ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin për raportimin e aktivitetit të kryer gjatë periudhës 23.08.2019 deri më datë 23.08.2020, për shqyrtim në AKBN jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi e lejes minerare, pra në datën 23/07/2020.

Në rast të mosrespektimit të këtij afati në zbatim të nenit 45, pika 1, shkronja dh) e ligjit nr.10304, datë 15/07/2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, shoqëria Juaj do të gjobitet me një shumë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Mosrespektimi i këtij afati për herë të dytë, dënohet me dyfishin e gjobës së parashikuar dhe mund të shoqërohet me pezullimin e lejes minerare deri në plotësimin e detyrimit ligjor.

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!*

DREJTORI EKZEKUTIV

